

Projekt

“Për organizimin e konkurseve në shkollat e sistemit para- universitar mbi konceptet dhe parimet e të drejtës së autorit dhe të drejtave të lidhura me to.”

Vendi: Në Qytetet kryesore të Republikës së Shqipërisë.

Koha: Prej 1 – 26 prill 2014.

Organizatorë: Ministria e Kulturës, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Zyra Shqiptare për të drejtën e Autorit, Drejtoritë Rajonale të Arsimit.

I. Qëllimi:

Në kuadër të Ditës Botërore të Pronësisë Intelektuale, e cila kremtohet me 26 prill të çdo viti, si dhe në zbatim të politikave të qeverisë shqiptare në luftën kundër piraterisë dhe shkeljes së pronësisë intelektuale Zyra Shqiptare për të drejtën e Autorit, me mbështetjen e Ministrisë së Kulturës, Ministrisë së Arsimit dhe Sportit si dhe **Drejtoreve Rajonale të Arsimit**, do të ndërmarre një sërë aktivitete për gjatë muajit Prill 2014, përfshirë edhe **organizimin e konkureseve në disa shkolla të sistemit para-universitar të vendit mbi konceptet dhe parimet bazë të të drejtës së autorit dhe të drejtave të lidhura me to.**

Konkursi ka për qëllim rritjen e ndërgjegjësimit të nxënësve dhe mesuesve për çështjet e të drejtave të pronësisë intelektuale si **dhe sensibilizimin mbi të drejtën e autorit në shkolla, e cila mendojmë se do të ketë efekt në uljen e piraterisë së pronësisë intelektuale, duke ditur se këto grupmosha janë edhe përdorues masiv të kësaj pasurie. Eksperienca botërore ka treguar se veprimtari të tilla sjellin impakte pozitive dhe frytdhënëse në luftën kundër piraterisë dhe kudravajtjeve si një detyrim i Shqipërisë për marrjen e statusit të vendit kandidat në BE.**

Konkursi ka për qëllim t'u bëjë jehonë politikave të reja të qeverisë shqiptare lidhur me nevojat emergjente në luftën kundër piraterisë dhe shkeljes së pronësisë intelektuale që ekziston në Shqipëri si një detyrim që rrjedh edhe nga neni 73 i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, në të cilin palët konfirmojnë rëndësinë e sigurimit të nivelit të posaçëm të mbrojtjes dhe vendosjes së të drejtave të pronësisë intelektuale në Shqipëri në nivel të ngjashëm me atë të Bashkimit Europian.

Zbatimi i së drejtës në lidhje me mbrojtjen e pronësisë intelektuale, është një element themelor për zhvillimin e konkurrencës së rregullt dhe të drejtë në çdo aspekt të jetës sociale dhe ekonomike të një vendi. Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, në nenin 27 të saj specifikon se: “Gjithkush ka të drejtë të mbrojë interesat morale dhe materiale, që rrjedhin nga çdo krijimtari shkencore, letrare dhe artistike, autor i të cilave është ai vetë” Ministria e Arsimit luan një rol thelbësor në krijimin dhe forcimin e ndërgjegjshmerisë qytetare në çështjet e të drejtave të pronësisë intelektuale. Pikerisht, ndërgjegjësimi i publikut si dhe arsimimi në këto çështje janë ndër shtyllat kryesore të Strategjie Kombëtare të Zbatimit të të Drejtave të PI

2010-2015. Sa më i madh të jetë informimi i konsumatorit për rëndësinë dhe rolin e të drejtave të PI-së, aq më i ulët do të jetë niveli i piraterisë dhe shkeljeve të tjera në vend.

Zyra Shqiptare për të Drejtën e Autorit (ZSHDA) është një institucion qëndror, person publik juridik, i ngritur nga Ministria e Kulturës, për të përmbushur detyrimet e Shqipërisë në fushën e të drejtave të autorit dhe zbatimit të tyre, prandaj do të udhëheqë anën teknike të këtij konkursi.

Bazuar dhe në dokumentat e tjerë strategikë:

- Marrëveshjen e Asociim -Stabilizimit
- Strategjinë Kombëtare të Zbatimit të të Drejtave të pronësisë intelektuale;
- Rekomandimet e dhëna nga asistenca e huaj e BE në kuadër dhe të projektit IPA 2008

II. Objekti kryesor:

Shkollat e mesme dhe 9 – vjeçare: përveç elementeve informues, në këto institucione propozohet konsolidimi i masave arsimore që fokusohen në shkeljet e të drejtës së autorit (në muzikë, video lojëra etj.) dhe ndëshkimin e tyre. Kjo gjë mund të zhvillohet në kuadrin e mësimave të përgjithshme në lëndën e qytetarisë. Organizimi i konkurseve të tilla në shkolla ndikojnë në rritje dhe informimin e kësaj grupmoshe me koncepte të reja për ta.

III. Objektivat e tjera:

- Forcimi i bashkëpunimit midis ZSHDA dhe Ministrisë së Arsimit dhe Drejtorive Rajonale Arsimore në rrethe.
- Rritja e ndërgjegjësimit të nxënësve, studentëve dhe mesuesve për çështjet e të drejtave të pronësisë intelektuale.
- Përshtatja graduale e kurrikulave mesimore në të gjitha nivelet e arsimit, duke përfshirë në to edhe temat e të drejtave të pronësisë intelektuale;

IV. FAZAT E MBAJTJES SË KONKURSIT

Fazae parë: Prej 1 – 13 prill 2014

Në këtë fazë konkursi zhvillohet fillimisht brenda çdo klase (duke filluar nga klasa e tetë deri në klasën e 12-të), pastaj vijon mes klasave të të njëjtit vit (kur shkolla ka klasa paralele) dhe në fund veprimtaria kulmon me zhvillimin e garës midis klasave fituese ku shpallet edhe klasa më e mirë për shkollën 9- vjeçare dhe po kështu edhe klasa më e mirë për shkollën e mesme, e cila do të përfaqësojë shkollën në konkursin që do të mbahet në nivel rrethi.

Faza e dytë: Prej 14 – 20 prill 2014

Në këtë fazë konkursi zhvillohet në qendër të çdo rrethi mes përfaqësuesve të skudrave fituese të çdo shkolle 9-vjeçare dhe të mesme të rrethit. Konkursi për rrethet e vogla mendohet të zhvillohet me 18 prill 2014, ndërsa për rrethet e mëdha më 16-17 dhe 18 prill 2014, sipas një liste dhe kalendari të miratuar në bashkëpunim me Drejtoritë Rajonale Arsimore.

Kjo fazë përfundon me shkollën fituese në nivel rrethi e cila do të përfaqësojë rrethin prej nga vjen, në konkursin që do të mbahet në nivel kombëtar në Tiranë. Po kështu do të shpërndahen çertifikata për çdo shkollë pjesëmarrëse nga organizatorët e veprimtarisë. Vendi ku do të mbahet konkursi do të njoftohet paraprakisht me shkrim nga organizatorët.

Faza e tretë: Prej 21 – 26 prill 2014

Faza përmbyllse e konkursit do të zhvillohet në Tiranë në datat 25 dhe 26 prill 2014, me pjesëmarrjen e shkollave që përfaqësojnë secilin rreth të vendit, sipas një liste dhe kalendari të miratuar në bashkëpunim me Minsitrinë e Arsimit dhe Drejtoritë rajonale të Arsimit.

Në fund të kësaj faze do të shpallet edhe shkolla fituese në nivel kombëtar si dhe do të jepen çertifikata për çdo shkollë pjesëmarrëse në këtë veprimtari kombëtare nga organizatorët.

Vendi ku do të mbahet konkursi do të njoftohet me shkrim.

V. Institucionet përfituese :

Institucionet e përfshira në këtë projekt janë:

- Ministria e Arsimit dhe Sportit;
- Ministria e Kulturës;
- ZSHDA;
- Drejtoritë Rajonale Arsimore;
- Shkollat 9-vjecare;
- Shkollat e mesme;

VI. Grupi i Punës :

- **Z. Mujë Buçpapaj** – Drejtor i ZSHDA
- **Znj.Zamira GJINI**- Drejtore e Drejtorisë së Arsimit Parauniversitar në MAS
- **Z. Ilir Kanini** – **Specialist MAS**
- **Zoti Evien Dako**, Përgjegjës i Sektorit të Regjistrim- Çertifikim – Inspektimit
- **Zonja Merita Cenaj** – Përgjegjëse e Sektorit të Agjensive të Administrimit Kolektiv;
- **Sonila Meka** – Specialiste e Marrëdhënieve me Jashtë dhe me Publikun, ideatore dhe kordinatore e projektit.
- **Lisjana Elezaj** – Specialiste e Gjyqimit të ankimeve

VII. Pritshmëritë nga ky projekt:

Pritshmëritë nga ky projekt do të jenë pozitive. Edukimi dhe informimi i brezit të ri është themelor në uljen e piratësisë në një vend. Eksperienca botërore ka treguar rezultate të dukshme dhe realiste në këtë drejtim. Ajo cka synohet të arihet nëpërmjet kësaj nisme janë:

- ✓ Përcaktimi i roleve dhe i përgjegjësisë që kanë Institucionet Arsimore së bashku me Ministrinë përkatëse lidhur me zbatimin e të drejtave të pronësisë Intelektuale.

- ✓ Zhvillimi i kurrikulave mesimore në të gjitha nivelet e arsimit, duke përfshirë në to edhe temat të vecanta të drejtave të pronësisë intelektuale.
- ✓ Fushata periodike ndërgjegjësimi që bazohen në krijimtarinë e zhvilluar nga vetë nxënësit. Fëmijëve dhe familjeve të tyre duhet t'u përcillen mesazhe të qarta duke përfshirë, për shëmbull “ditet e krijimtarisë” në secilën shkollë.

VIII. PËRGJEGJËSITË E BASHKË - ORGANIZATORËVE

a. Zyra Shqiptare për të Drejtën e Autorit(ZSHDA) merr përsipër:

- Formulimi i pyetjeve të thjeshta dhe të kuptueshme për ciklin, të cilit i referohemi, ku qëllimi është rritja e ndërgjegjësimit dhe sensibilizimit mbi të drejtën e autorit në brezat që edukohen. Ky pyetësor do të përmbajë mbi 50 pyetje të cilat janë hartuar nga specialistët e ZSHDA-së, e cila kjo e fundit me ndihmën dhe të donatorëve, merr përsipër gjithashtu dhe shumëfishimin e tyre në një numër të caktuar për t'u shpërndarë në shkollat e vendit si dhe shpenzimet e udhëtimit të nxënësve për në qëndër të rretheve dhe fituesve të rretheve në fazën finale në Tiranë.
- Konkursët do të zhvillohen në shkallë Drejtorie Arsimore Rajonale, duke dalë fituesit për çdo Drejtori Arsimore Rajonale.
- Konkursi final do të organizohet në Tiranë, ku do përzgjidhet shkolla fituese si dhe do të shpërndahen certifikata për pjesëmarrësit si dhe cmime simbole për fituesit e vendeve të treta, të dyta dhe të para.
- Veprimtaritë do të monitorohen nga punonjësit e ZSHDA-së, sipas kalendarit që do të përcaktohen nga DAR, si dhe në përbërje të jurisë do të jenë:
 - Dy përfaqësues të ZSHDA;
 - Inspektori i aktiviteteve të letërsisë të DAR;
 - Profesori i letërsisë apo i një lëndë tjetër për tu njohur me tematikën e konkursit.
- Ndjekjen, në bashkëpunim me inspektorët e aktiviteteve kulturore të DAR, të të gjithë ecures së konkursit deri në përmbylljen me sukses të të gjithë këtij aktiviteti.
- Shpërndajen e certifikatave të pjesëmarrjes për të gjitha shkollat e përfshira dhe cmime simbolike për shkollat fituese.

b. Ministria e Arsimit dhe Sportit si dhe DAR-et marrin përsipër:

- Dhenia e lejes për venien në dispozicion të ambjenteve të shkollave;
- Disponueshmërinë e mesuesve të letërsisë për të organizuar konkurset në shkolla si dhe organizimin e tyre;
- Në cilësinë e bashkë-organizatorit të këtij aktiviteti, Ministria e Arsimit dhe Drejtoritë Rajonale Arsimore, do të mundësojnë dhe disponibilitetin e inspektorit të aktiviteteve kulturore për të përmbyllur me sukses gjithë këtë aktivitet.
- Numrin e shkollave në shkallë qarku për të bërë të mundur llogaritjen e printimeve të pyetësorit nga ZSHDA.